

Papa bën thirrje
për ndaljen e luftërave
në mbarë botën | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MUNTER: SHBA-ja NUK DO TË KETË MË QASJE TRADICIONALE NDAJ KOSOVËS DHE SERBISË

FAQE 4-5



Ish-diplomati amerikan Cameron Munter thotë se negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve nuk mund të

vazhdojnë pa ndryshuar asgjë, "nëse nuk duam t'i kalojmë edhe 15 vjet të tjerë duke pritur". Ai në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë"

beson se rikthimi i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë do të imponojë patjetër ndryshim të strategjisë pasi, siç thotë, Trumpi do marrëveshje

OPINION

MINISTRI IDIOT! F. 6

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE



MBI 10 000 IMIGRANTË U MBYTËN KËTË VIT NË TENTIM PËR TË SHKUAR NË SPANJË F. 2

USHTARËT E KFOR-it KRYEJNË TRAJNIME PËR KONTROLLIN E TRAZIRAVE TË TURMAVE NË KOSOVË F. 3

KOSOVËS I DUHET PËRKRAHJA E PARTNERËVE NDËRKOMBËTARË PËR PËRBALLJE MË EFIKASE ME SFIDAT KLIMATIKE F. 6

EKONOMI

MURATI: PËR HERË TË PARË NË HISTORINË E VENDIT TË HYRAT BUXHETORE KANË TEJKALUAR SHIFRËN 3 MILIARDË EURO F. 8


KOSOVA MBYLL DY NDËRMARRJE PUBLIKE SERBE NË VERI F. 7

SPORT



XHAKA NË FORMACIONIN E VITIT NË BUNDESLIGA F. 10

PAGESA
E RRYMËS
NË VERI,
NËN 20 % F. 8



GUVERNATORI
ISMAILI: VITI
2024 MBYLLET
ME RRIJTJE
EKONOMIKE
4.3 % F. 7



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbi 10 000 imigrantë u mbytën këtë vit në tentim për të shkuar në Spanjë

MADRID, 26 DHJETOR - Më shumë se 10 000 imigrantë humbën jetën në përpjekje për të mbërritur në Spanjë përmes detit, sipas një raporti të publikuar të enjten nga një grup spanjoll për të drejtat e imigrantëve. Kjo shifër nënkupton se 30 imigrantë kanë vdekur mesatarisht çdo ditë në vitin 2024 në tentim për të shkuar në Spanjë përmes anijeve, tha grupi Caminando Fronteras.

Numri i të vdekurve u rrit për 58 për qind, krahasuar me vitin e kaluar, thuhet në raport. Dhjetëra mijëra imigrantë u larguan nga Afrika

Perëndimore më 2024 në drejtim të Ishujve Kanari të Spanjës, të cilët ndodhen në afërsi të bregdetit afrikan, që është përdorur bujshëm si pikënisje drejt kontinentit të Evropës.

Caminando Fronteras tha se shumica e 10 457 vdekjeve të regjistruara deri më 15 dhjetor ndodhën përgjatë të ashtuquajturës rruga atlantike, e cila cilësohet si një prej më të rrezikshmeve në botë. Kjo organizatë i mbledh shifrat nga familjet e imigrantëve dhe nga të dhënat zyrtare të atyre që shpëtohen.

Në mesin e të vdekurve ishin 1

538 fëmijë dhe 421 gra. Prilli dhe maji ishin muajt më vdekjeprurës, sipas raportit.

Caminando Fronteras, gjithashtu, theksoi një "rritje të madhe" më 2024 të imigrantëve që nisen nga Mauritania, e cila është bërë pikënisja kryesore në rrugën drejt Ishujve Kanari.

Në shkurt, Spanja ia dha Mauritanisë 210 milionë euro për ta ndihmuar t'i luftojë trafikantët me imigrantë dhe të mos i lejojë anijet me imigrantë të nisen drejt ishujve të saj. Ministria e Brendshme e Spanjës thotë se më shumë se 57 700 imigrantë mbërritën në



Spanjë përmes anijes deri më 15 dhjetor këtë vit, që është një rritje prej rreth 12 për qind

krahasuar me vitin e kaluar. Shumica e tyre erdhën përmes rrugës atlantike.

Azerbajxhani në zi për viktimat e aksidentit ajror

BAKU, 26 DHJETOR - Në Azerbajxhan më 26 dhjetor është shpallur ditë zie për t'i nderuar viktimat nga avioni i pasagjerëve që u rrëzua një ditë më parë në Kazakistan. Avioni i kompanisë Azerbaijan Airlines kishte 67 persona në bord. Autoritetet kanë thënë se 38 persona kanë vdekur dhe 29 i kanë mbijetuar përplasjes.

Fluturakja ishte nisur nga kryeqyteti i Azerbajxhanit, Baku, për në Grozni të rajonit rus, Çeçeni. Por, avioni devijoi rrugën dhe tentoi të bënte ulje emergjente afër qytetit Aktau në perëndim të Kazakistanit.

Autoritetet në Azerbajxhan dhe Kazakistan kanë nisur hetimet për ta kuptuar shkakun e rrëzimit, teksa është gjetur edhe incizimi nga



kabina e pilotit. Presidenti azerbajxhanas Ilham Aliyev tha se ende është herët të përcaktohet shkakun e rrëzimit të avionit, por

sugjeroi se moti i lig mund të ketë kontribuar në incident. "Informacioni që më është dhënë është se avioni ndryshoi rrugën nga Bakuja

për në Grozni për shkak të përkeqësimit të kushteve atmosferike dhe u nis drejt aeroportit të Aktaut para se të rrëzohej", tha ai.

Ndërkaq, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Azerbajxhanit tha se "të gjithë skenarët janë duke u hetuar".

Në avionin e rrëzuar ishin 42 shtetas të Azerbajxhanit, 16 të Rusisë, gjashtë të Kazakistanit dhe tre të Kirgizisë.

Zëvendëskryeministri kazak Qanat Bozymbaev - i cili është përgjegjës për komisionin e posaçëm qeveritar për hetimin e incidentit - tha se shumica e viktimave nuk kanë mundur të identifikohen menjëherë, pasi kanë pësuar dëgjie të rënda.

Sa iu përket të lënduarve, ai

tha se disa kanë lëndime të moderuara, por ka edhe persona në gjendje të rënduar shëndetësore që kanë pësuar dëgjie të mëdha.

Ndërkaq, sa iu përket të shpëtuarve, nëntë janë rusë, të cilët janë dërguar në Moskë me një avion nga Ministria ruse e Emergjencave më 26 dhjetor.

Kompania Azerbaijan Airlines ka pezulluar të gjitha fluturimet nga Bakuja drejt Çeçenisë derisa të kryhen hetimet për tragjedinë.

Agjencia ruse e lajmeve, Interfax, ka cituar zyrtarë të kenë thënë se avioni kishte kaluar të gjitha kontrollet në tetor dhe piloti kishte "përvojë të madhe" me mbi 15 000 orë fluturim.

Papa bën thirrje për ndaljen e luftërave në mbarë botën

VATIKAN, 26 DHJETOR - Papa Françesku bëri thirrje që "të ulen armët" në mbarë botën gjatë adresimit të tij për Krishtlindje. Ati i Shenjtë bëri thirrje për paqe në Lindjen e Mesme, Ukrainë dhe Sudan dhe dënoi "situatën shumë të rëndë" humanitare në Rripin e Gazës.

Ai përdori mesazhin tradicional drejtuar 1.4 miliard katolikëve në mbarë botën, duke kërkuar bisedime për paqe të drejtë në Ukrainë, teksa ky shtet u përball me sulme masive raketore dhe me dronë në Krishtlindje.

Papa, po ashtu, kërkoi armëpushim në Gazë dhe lirim të pengjeve izraelite që po mbahen nga Hamasi, grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e

Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Mendoj për komunitetet e krishtera në Izrael dhe Palestinë, veçmas në Gazë, ku situata humanitare është jashtëzakonisht e rëndë", u tha ai mijëra besimtarëve që u mblodhën para Bazilikës së Shën Pjetrit në Romë për adresimin e Papës. "Uroj të ketë armëpushim, uroj që pengjet të lirohen dhe t'u jepet ndihma njerëzve që janë rraskapitur nga uria dhe lufta".

Ai, po ashtu, bëri thirrje për paqe në Sudan, ku po zhvillohet një luftë brutale civile, që ka nisur 20 muaj më parë dhe që ka bërë që miliona persona të përballen me uri.

Në ditën e Krishtlindjes, Ukraina u përball me sulme masive ruse. Ukraina që dy vjet



shënon Krishtlindjen më 25 dhjetor në vend më 7 janar, kur shumica e besimtarëve ortodoksë e shënojnë këtë

festë. Festimet për Krishtlindje ishin të heshtura në vendlindjen biblike të Jezu Krishtit, në

qytetin e Betlehemit që gjendet në Bregun Perëndimor të pushtuar nga Izraeli.

Që kur ka nisur lufta në Gazë në tetor të vitit të kaluar, ky qytet palestinez ka hequr dorë nga pema gjigante e Krishtlindjes dhe nga dekorimet që tërhiqnin shumë turistë. "Këtë vit kemi kufizuar gëzimin tonë", tha kryetari i Betlehemit, Anton Salman, për AFP-në.

Rreth 1 100 të krishterë jetojnë në Gazë, ku për Krishtlindje qindra u mblodhën në një kishë për t'u lutur që lufta të mbarojë. "Kjo krishtlindje mban erën e vdekjes dhe shkatërrimit", tha George al-Sayegh, i cili për javë të tëra është strehuar në një kishë ortodokse greke në qytetin e Gazës.

Azem Syla shpallet i pafajshëm në rastin 'Toka'

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Pas tetë vjetësh është shpallur aktgjykimi i rastit 'Toka'. Ish-komandanti i UÇK-së dhe ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Azem Syla, është shpallur i pafajshëm. Për triumfin në këtë rast ka shkruar në "Facebook" avokati Besnik Berisha, i cili ka thënë se është lumtur që ishte pjesë e fitores së kësaj beteje me z. Syla. "Triumf si para katër viteve! Këtë foto e patëm realizuar

para katër viteve me z. Azem Syla, i njohur si komandant 'Daja' përderisa ishim në pauze në bufenë e Dhomave të Specializuara në Hagë, aty ku për tre dite rresht u përballëm me padrejtësinë dhe dolëm te buzëqeshur e fitimtarë. U patëm dakorduar që këtë foto ta postojmë vetëm atëherë kur ta fitojmë edhe betejen tjetër kundër Serbisë, në procesin skandaloz që e filloi EULEX-i kundër tij, me

aktakuzën që u gatua në Serbi. Sot edhe këtë beteje e fituam, sot drejtësia triumfoj dhe sot u poqën kushtet që këtë foto ta postojmë. Jam i lumtur që isha pjesë e këtyre betejave në cilësinë e avokatit të z. Syla, i cili, përkundër ofertave që të angazhojë avokat ndërkombëtar, me zgjodhi mua si të vetmin që i beso! Urime z. Syla dhe familjes së tij!", ka shkruar avokati Berisha.



Çedomir Aksiq dënohet në mungesë me 15 vjet burgim për krime lufte

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me 15 vjet burgim Çedomir Aksiqin për krime lufte të kryera në komunën e Shtimes.

Gjykimi ndaj tij është zhvilluar në mungesë dhe ai është dënuar për krime që, sipas aktakuzës, janë kryer në periudhën janar-maj 1999.

Në nëntor të vitit 2023 nisi gjykimi ndaj Aksiqit.

Ky është rasti i parë i një gjykimi të tillë, pasi gjykimet në mungesë lejohen me Kodin e ri të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në seancën e parë, Prokuroria tha se kishte shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore që Aksiq të ishte i pranishëm në gjykatë, por nuk ishte arritur.

Sipas aktakuzës, që u ngrit majin e vitit të kaluar, Çedomir Aksiq, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, kishte urdhëruar dëbimin e banorëve të lagjes në pikën e quajtur

"Kodra e Gështenjave", vend midis fshatrave Mulapolc, Reçak dhe Petrovë në komunën e Shtimes.

Në aktakuzë thuhet se ata më pas kishin djegur shtëpitë e të dëmtuarave duke u shkakuar kështu dëme morale dhe materiale.

Në vendin e quajtur "Lugu i Neshës", në Petrovë të Shtimes, Çedomir Aksiq është akuzuar se e kishte ekzekutuar një person, familjen e të cilit paraprakisht e ndaluar.

Gjithashtu, sipas aktakuzës, Aksiq kishte marrë pjesë në vrasjen e Hajriz Brahimit, Hakin Muratit, Sabri Muratit, Arif Muratit, Ahmet Mustafes, Sadik Mujotës, Skënder Halitit dhe Hanumshahe Mujotës, në Reçak.

Sipas aktakuzës, Aksiq është i lindur në Shtime, por adresa e tij aktuale është në Serbi.

Ndryshe, sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykimet në mungesë parashihen të



mbahen në rastet kur i akuzuari heq dorë vetë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimet gjyqësore.

Një gjykim i tillë mund të mbahet kur Prokuroria dhe Gjykata t'i kenë shtjerrë të gjitha mjetet për sigurimin e

pranisë së të akuzuarit.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 303, gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi, nëse i

akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim.

Aty thuhet, po ashtu, se për marrjen e këtij vendimi, gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta gjetur të akuzuarin.

Por, gjykime të këtij lloji më herët ishin kritikuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Prishtinë. Nga ky Fond kanë argumentuar se fillimisht viktimat mund të jenë të kënaqura me drejtësinë, por më pas ata zhgënjehen pasi edhe kur ndonjë i akuzuar dënohet, më pas e kuptojnë se ai nuk do të arrestohet.

Në luftën e viteve 1998-1999 mbi 13 000 civilë besohet se janë vrarë në Kosovë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Të pagjetur, edhe sot e kësaj dite, mbeten mbi 1 600 persona - shumica prej të cilëve shqiptarë.

Bedri Hamza: Do t'i mbështes bizneset vendore me grante deri në 30 % të investimeve



PRISHTINË, 26 DHJETOR - Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, ka takuar kryetarin Nazmi Viqa dhe anëtarët e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane. Ai ka thënë se rritja e qëndrueshme ekonomike është në thelb të programit të tij. "Unë do t'i mbështes bizneset vendor me grante deri në 30 % të investimeve, me modernizimin

e teknologjisë së prodhimit, me qasje më të mirë në financa dhe pako të veçanta për rritjen e eksportit", ka shkruar Hamza në "Facebook".

Njëkohësisht, ka thënë se do të krijojnë ambient më të favorshëm për investime të huaja dhe do ta themelojnë Bursën e Kosovës, si platformë të tregut të kapitalit për sektorin privat, ku do të tregtohen

aksionet dhe letrat me vlerë të korporatave në Kosovë. "Një nga përfitimet kryesore të kësaj burse do të jetë mundësia për diasporën dhe investitorët e huaj që të investojnë në kompanitë tona, duke sjell kapital të ri dhe duke kontribuar në rritjen e ekonomisë vendore. Kosova mundet ma mirë!", ka deklaruar Hamza.

Ushtarët e KFOR-it kryejnë trajnime për kontrollin e trazirave të turmave në Kosovë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ushtarët letonezë të misionit të KFOR-it në Kosovë kanë përfunduar trajnimin për kontrollin e trazirave të turmave në poligonin e qitjes në Kçiç të Mitrovicës. Ky trajnim është realizuar për të siguruar gatishmëri operacionale dhe për të

mundësuar që ushtarët të jenë të gatshëm për çdo mision.

Në një deklaratë, KFOR-i theksoi se këto përpjekje janë pjesë e misionit të përditshëm për të garantuar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë. "KFOR-i vazhdon ta zbatojë

mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme".





Munter: ShBA-ja nuk do të ketë më qasje tradicionale ndaj Kosovës dhe Serbisë

Ish-diplomati amerikan Cameron Munter thotë se negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve nuk mund të vazhdojnë pa ndryshuar asgjë, “nëse nuk duam t’i kalojmë edhe 15 vjet të tjerë duke pritur”. Ai në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë” beson se rikthimi i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë do të imponojë patjetër ndryshim të strategjisë pasi, siç thotë, Trumpi do marrëveshje

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ish-diplomati amerikan Cameron Munter thotë se negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve nuk mund të vazhdojnë pa ndryshuar asgjë, “nëse nuk duam t’i kalojmë edhe 15 vjet të tjerë duke pritur”. Ai beson se rikthimi i Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë do të imponojë patjetër ndryshim të strategjisë pasi, siç thotë, Trumpi do marrëveshje. “Synim i tij nuk është t’i fusë serbët dhe kosovarët në Bashkimin Evropian. Synim i tij është ta bëjë më të mirën për Shtetet e Bashkuara, ta bëjë Amerikën sërish madhështore”, thotë Munter në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë”. Sipas tij, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka avantazhe dhe disavantazhe në raport me presidentin e zgjedhur, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka punuar për krijimin e

lidhjeve personale me njerëzit e administratës së tij. Munter ishte ambasador i ShBA-së në Serbi kur Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008.

Z. Munter, Kosova dhe Serbia janë të angazhuara në negociatat për normalizimin e marrëdhënieve për gati 14 vjet, por qëllimi përfundimtar mbetet ende larg. Nëse dikush do të duhej të mbante përgjegjësi për këtë situatë, kush besoni se do të ishte?

Cameron Munter: Nuk jam adhurues i madh i gjetjes së fajtorit. Jam adhurues i gjetjes së zgjidhjes. Ndaj, dua të bëj disa vlerësime se çfarë ka shkuar keq dhe çfarë mund të ketë shkuar mirë. Unë mendoj se fokusi ka qenë në gjëra të vogla, në detaje - qofshin ato targa të makinave apo dokumente... Këto natyrisht se janë të rëndësishme në jetën e përditshme. Por, unë kam

ndjesinë se duhet të zgjerohet diapazoni dhe kjo të mos trajtohet vetëm si çështje e Kosovës dhe Serbisë. Sepse, në të gjithë Ballkanin Perëndimor ka çështje shumë të mëdha dhe sa më shumë që zhytemi në detaje, aq më pak përparim bëjmë. Megjithatë, do ta thyej pak rregullin tim dhe do ta fajësoj pak Bashkimin Evropian, ku ka një tendencë për t’u marrë me detaje dhe jo me strategji të shkallës së gjerë. Unë mendoj se strategji në shkallë të gjerë do të ishte sikur t’i shqyrtonim të gjitha çështjet në rajon, e jo vetëm çështjet institucionale. Për çfarë brengoset BE-ja? Brengoset për imigrimin. Brengoset për energjinë. Brengoset për infrastrukturën. Këto janë çështje që Ballkani mund të ndihmojë të zgjidhen. Nëse do të merreshim me to, më shumë sesa me detaje të vogla, mendoj se do të bënim

më shumë përparim, sepse ato janë në interesin e të gjithëve, jo vetëm të Kosovës dhe të Serbisë, por edhe të Bashkimit Evropian, e madje edhe të ShBA-së. Pra, përgjigja ime për ju është: nëse duam të ketë përparim mes Kosovës dhe Serbisë, ai duhet të nxirret nga zgjidhja e çështjeve të mëdha.

Pra, mendoni se ndërmjetësuesit ndërkombëtarë kanë mundur të bëjnë më shumë në këtë proces?

Cameron Munter: Po. Marr si shembull Procesin e Berlinit, të mbledhen çdo gjashtë muaj, ta bëjnë listën e problemeve... Unë nuk dua të jem skeptik, por ky proces [i negociatave] e ka treguar veten jo në 3-4 vjetët e fundit, por në dhjetë vjetët e fundit, sepse nuk ka pasur përparim. Unë jam larguar nga Serbia në vitin 2009, pra para 15 vjetësh, dhe shumë prej problemeve atje mbeten të njëjta. Mendoj se procesi aktual duhet të ndryshojë dhe mendoj se do të ketë një shtysë për ta ndryshuar atë me ardhjen e administratës së re në Uashington. Administrata e re në Uashington nuk është mike e Bashkimit Evropian. Donald Trump nuk është dikush që mendon shumë për Bashkimin

Evropian. Donald Trump nuk brengoset, ai do marrëveshje. Ai do marrëveshje me Serbinë, me Hungarinë, me Rumaninë... Nuk ka rëndësi. Ai do marrëveshje dhe nuk është strategjik. Kjo do të thotë se mënyra tradicionale strategjike me të cilën kanë biseduar Bashkimi Evropian dhe gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk është më qëllim i Donald Trumpit. Atij nuk i intereson nëse dikush do të hyjë ndonjëherë në Bashkimin Evropian. Atij i intereson arritja e një marrëveshjeje. Unë mendoj se njerëzit që jetojnë në rajon, njerëzit që punojnë në rajon, duhet ta kenë parasysh se qasja e deritashme nuk do të funksionojë më - nuk do të ketë më një Gabriel Escobar [ish-i dërguar i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor] që e mbështet Mirosllav Lajçakun [përfaqësues i posaçëm i BE-së në dialogun Kosovë-Serbi]. Amerikanët nuk do të jenë më pjesë e kësaj. Ata do të thonë: kemi probleme me gazin natyror, me imigrimin, me investimet... Do të na ndihmoni t’i zgjidhim apo jo? Dhe, kështu, Kosova, Serbia, Mali i Zi... të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor mund të jenë pjesë e përgjigjes, në vend se të jenë

problemi që BE-ja duhet ta zgjidhë.

Marrë parasysh se ka disa çështje urgjente ndërkombëtare në këtë kohë, sa mendoni se do të përfshihet administrata e re amerikane në marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Cameron Munter: Mendoj se fokusi i Shteteve të Bashkuara as që do të jetë në çështjet e jashtme, por në çështjet e brendshme. Kam qenë në Uashington së voni dhe kam dëgjuar sesi amerikanët flasin për tri prioritete. Prioriteti i parë është Kina, prioriteti i dytë është Kina dhe prioriteti i tretë është Kina. Ajo është e gjitha për çfarë flasin. Ndaj, mendoj se angazhimi në Ballkan do të vijë në vazhdim e çështjeve të brendshme. Nëse amerikanët do të jenë vërtet të ashpër ndaj Kinës, një gjë e tillë nuk do të jetë e lehtë për [presidentin e Serbisë] Aleksandar Vuçiq, sepse ai ka punuar shumë për të zhvilluar marrëdhënie të mira me kinezët dhe marrëdhënie të mira me amerikanët. Por, këtu, ekziston edhe elementi personal. Richard Grenell, i cili tani është emëruar këshilltar për projekte speciale i presidentit Trump, dhe dhëndri i tij, Jared Kushner, kanë shfaqur interes të madh për investime në Shqipëri, në Serbi e vende të tilla. Pra, do të ketë njerëz që do të ndjekin marrëveshje, por jo në stilin tradicional amerikan. Mënyrë tradicionale ka qenë kur [sekretari amerikan i Shtetit] Antony Blinken ka shkuar në Bruksel, kur Gabriel Escobar ka shkuar në Ballkan... E, tani, mënyrë jotradicionale do të jetë ndjekja e marrëveshjeve jo me synim strategjik, por oportunist.

A prisni që Kosova dhe Serbia të detyrohen të bëjnë kompromise të vështira?

Cameron Munter: Ato mund të detyrohen. Qëllimi i vjetër ishte: nëse e bëni këtë, do të hyni në Bashkimin Evropian - si formë e shpërblimit; nëse nuk e bëni, nuk do të hyni kurrë. Synim i Donald Trumpit nuk është t'i fusë serbët dhe kosovarët në Bashkimin Evropian. Synim i tij është ta bëjë më të mirën për Shtetet e Bashkuara, ta bëjë Amerikën sërish madhështore. Ai nuk thotë 'bëjeni Kosovën sërish madhështore', 'bëjeni Serbinë sërish madhështore'. Nëse njerëzit që i drejtojnë këto vende, [kryeministri i Kosovës, Albin] Kurti, dhe [presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq, i kushtojnë vëmendje... ata do të përpiqen t'i përshtatin interesat e tyre me interesat e Trumpit. Për mua, interesat e Trumpit nuk janë gjithmonë të qarta, ndaj atyre do t'u duhet të zbulojnë se çfarë të bëjnë. A do të thotë kjo se ata duhet të bëjnë kompromise të dhimbshme? Ndoshta. Por, le të kujtojmë se nuk do të jenë në kontekstin e asaj që kemi pasur në të kaluarën. Unë nuk pres që të ketë aq shumë angazhim si në të kaluarën. Mund edhe të gabo, por çfarë nëse Trump

thotë: 'unë nuk dua që ju ta vazhdoni bashkëpunimin me Kinën'? Çfarë do të bëjë Aleksandar Vuçiq? Kompromis të dhimbshëm, apo jo? Pra, mund të ketë kompromise të dhimbshme, por jo të tilla që pritëshin në të kaluarën.

E, çfarë sa i përket Kosovës në atë rast? Kosova nuk është shumë e lidhur me Kinën.

Cameron Munter: Keni absolutisht të drejtë. Nëse udhëheqësit e Kosovës janë të zgjuar, do t'i thonë: 'ne jemi me ju, ne jemi të ashpër ndaj Kinës'. Ata do të duhej të luanin me këtë kartë. Por, Kurti është ndryshe nga Vuçiqi, ata nuk janë të ngjashëm në mënyrën se si u qasen problemeve. Kurtit do t'i duhet të punojë shumë për të krijuar një lidhje personale me njerëzit në administratën Trump. Në këtë drejtim, Vuçiq ka bërë punë më të mirë në të kaluarën.

Po thoni se Kurti është në disavantazh sa i përket kësaj?

Cameron Munter: Po, mendoj se ai është në disavantazh, sepse këtu ka një histori të lidhjeve personale. Vuçiq ka qenë te Trumpi në Shtëpinë e Bardhë. Ka një histori të marrëveshjeve biznesore. Ka premtime se do të ketë investime në rrugën kryesore në Beograd, në ndërtimin e një hoteli luksoz.

Ky lloj marrëdhënieje - mesa di unë - nuk ekziston midis Kurtit dhe njerëzve në administratën e re të ShBA-së. Shtetet e Bashkuara dhe Evropa kanë qenë të lidhura ngushtë në të kaluarën. Në katër vjetët e fundit, ato kanë thënë se politika e tyre është e njëjtë, por kjo nuk duket se ekziston më. Tani do të duhet një lloj i ri i politikës, në të cilën udhëheqësit e dy vendeve [Kosovës dhe Serbisë] do të duhet të vendosin: të shkojnë në drejtimin evropian apo në drejtimin amerikan?! Normalisht nëse ata janë të ndryshëm.

Dhe cila do të ishte zgjedhja më e mirë, sipas jush?

Cameron Munter: Sipas meje, ajo që duhet të bësh, është të marrësh informacione. Askush prej nesh nuk e di ende... Të vendoset në dhjetor të vitit 2024 se cila do të jetë politika, mendoj se nuk është një gjë e zgjuar. Ajo që duhet të bëjnë udhëheqësit e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, jo vetëm të Kosovës dhe të Serbisë, është të presin se kush do të merret më shumë me çështjet e tyre. Nëse ne flasim pas gjashtë muajsh, situata mund të jetë krejt ndryshe. Trump nuk do që të jetë i parashikueshëm. Për diplomatët tradicionalë si unë, kjo është e tmerrshme. Por, nëse kjo është ajo që ai do, ne duhet të pajtohemi.

Unë, si diplomat amerikan, kam besuar gjithmonë se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do t'i përkasin Bashkimin Evropian dhe familjes së vendeve



demokratike në Perëndim. Trump është presidenti i parë që kam parë, që nuk i intereson komuniteti i demokracive në Perëndim. Pra, është një botë e re. Ju duhet të shikoni se cilat janë avantazhet e juaja dhe çfarë mund të bëni. Por, këtë nuk do të mund ta dini derisa të kalojnë disa muaj të administratës së tij.

Do të shohim edhe 14 vjet të tjerë me negociata?

Cameron Munter: Jo, nuk mendoj ashtu. Mendoj se do të shohim opsione të tjera. Mund të ndodhë që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nuk bëhen kurrë anëtare të BE-së. Mund të ndodhë që vetë Bashkimi Evropian ndryshon dhe reformohet dhe nuk ka më ide ekspansioniste, që kanë qenë bazë e Bashkimit Evropian në 30 vjetët e fundit. Mund të ketë reforma brenda BE-së dhe ato të vijnë jo si rezultat i ngjarjeve në Ballkan, por si rezultat i mënyrës sesi përfundon lufta në Ukrainë, ose si funksionon tregtia me Kinën dhe me ShBA-në.

Pra, Ballkani Perëndimor duhet

të presë për të parë sesi ndryshojnë gjërat në botë përpara se të marrë vendime për të ardhmen e tij. Por, ju nuk keni nevojë vetëm për Gjermaninë dhe Amerikën që të marrin vendime për ju. Ju mund të merrni vendime edhe me vende të tjera.

Për shembull, për të pasur furnizime koherente me energji në të gjitha vendet në rajon, duhet të ndërtohen tubacione dhe infrastruktura. Ju nuk keni nevojë për Amerikën për ta bërë një gjë të tillë. Do të ishte një ndihmesë nëse Amerika do të ndihmonte, por mund ta bëni vetë, duke punuar së bashku. Dhe, nëse e bëni këtë, ju arrini përparim - edhe nëse Berlini mendon për diçka tjetër, ose Amerika mendon për diçka tjetër.

Do të ishte një gjë e zgjuar të mendohej për një Ballkan më të madh, në vend se të thuhet se 'ne jemi gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, që presim për të hyrë në Bashkimin Evropian, dhe kjo është e gjitha që bëjmë'.

Unë do të shikoja jashtë dhe do të thosha: si të merremi me

çështjet e tilla si gazi natyror? Çfarë qasjeje të përbashkët mund të ndjekim për të nxitur turizmin? Si të arrijmë që njerëzit tanë të kenë perspektivë për një të ardhme më të mirë dhe të mos varen nga amerikanët?

Por, a është kjo e mundur nëse Serbia nuk e njeht ende Kosovën?

Cameron Munter: Kosovarët mund të punojnë me grekët, kosovarët mund të punojnë me maqedonasit... Keni njerëz të tjerë në rajon, me të cilët mund të punoni. Ju nuk duhet të mendoni ashtu siç keni menduar në 15 vjetët e fundit. Mund të nisni një rrugë ndryshe, të ndërmerri iniciativa ndryshe. Nëse vazhdojmë të mendojmë vetëm për njohjen mes Kosovës dhe Serbisë, do t'i kalojmë edhe 15 vjet të tjerë duke prituri. Unë besoj se kjo nuk është thjesht një çështje diskrete mes dy vendeve. Kjo kërkon një zgjidhje më të gjerë, brenda së cilës Kosova dhe Serbia mësojnë të kenë një të ardhme të begatë, të drejtë dhe demokratike.

MINISTRI IDIOT!



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Krijesa pa histori dhe biografi: Hekuran Murati është, me nder me thënë, ministër i Financave në qeverinë kleptokratike (hajdute) të Albin Kurtit. U bë i “famshëm” kur botërisht tha se “më lirë do të na kushtonin mercenarët sesa ushtarët e

UÇK-së...”, në luftë për liri dhe çlirim. Në një vend normal dhe me një qeveri normale ai do të shkarkohej menjëherë duke u shndërruar në pacient të Prokurorisë Speciale. Në rrethana që jemi ku çështja e fundit që i intereson kësaj qeverie janë veteranët e luftës, invalidët e luftës, ish të burgosurit politikë, dëshmorët e kombit dhe sakrifikuësit tjerë për këtë liri dhe pavarësi që e kemi, ky farë mistreci që asgjë nuk ka kontribuar personalisht apo familjarisht vazhdon të tallet nga pozita e një maniake qeveritar. Po të kishte veteranë të luftës të organizuar dhe të vendosur, edhe nëse nuk do të shkarkohej, asnjëherë nuk do

t'i lejohej t'i fuste thundrat në objektin e Qeverisë apo të Kuvendit. Po të ishte një shoqatë e të Burgosurve Politikë që ende e ka një themi idealizmi, shkak se ish udhëheqësit e saj ishin kapur kokë e këmbë nga qeveria aktuale dhe antikombëtari Murati, ky farë sançoanço qeveritar, do të shporrej nga karrigia e pamerituar me asgjë. Ky farë jonjeri bëri çmos që t'ua shkurtojë përkrahjen financiare pengjeve të Hagës falë të cilëve u bë, me nder me thënë, ministër. Ky farë, me nder me thënë ministër, ka përgjegjësi direkte për 500 milionë euro tenderë njëburimor.

Po çka hëngri së fundi të duket shumë i mençur: As dy muaj para zgjedhjeve parlamentare, “për shkak të performancës së shkëlqyer ekonomike...”, qeveria Kurti 2, me llogaritarin Murati, me nder me thënë ministër mori vendim që pensionistët të marrin nga 100 euro shtesë sikur edhe fëmijët nga mosha 0-16 vjet, pavarësisht gjendjes materiale. Kriminelë ordinerë, të ndahen njëjtë mjete si për fëmijët e rasteve sociale, si për fëmijët e presidentes, kryeparlamentarit, kryeministrit, ministrave, deputetëve, diplomatëve dhe rasteve sociale që i kanë pagat mbi 2000 euro, e bëjnë vetëm

idiotët të zhveshur nga çdo përgjegjësi njerëzore, morale dhe institucionale. Ky farë jonjeriu doli me një ide gjeniale se: “ata që nuk duan t'i marrin këto 100 euro mund t'i refuzojnë duke plotësuar një formular online të projektuar nga ky idiot...”. Sikur të ishin parat e veta personale. E çka do të bëjë ky me këto para të refuzuara?! Përmes pecit të Albinut, do të ndajë 100 mijëshe euro tjera për filan gjyksat, filan-e cicat, filan-e bothët vetëm të jenë të pushtetit aktual. Dhe Listës Serbe. Dhe ky pastaj ka fytyrë të kërkohet vota!!! Po mendon se ka fytyrë, është i bindur, i pafytyri!

Kosovës i duhet përkrahja e partnerëve ndërkombëtarë për përballje më efikase me sfidat klimatike

PRISHTINË, 26 DHJETOR - “EC Ma Ndryshe” ka njoftuar se Republika e Kosovës përballet me sfida të konsiderueshme në raport me ndryshimet klimatike të cilat ndikojnë në mjedisin, ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Sipas kësaj organizate, për adresimin e tyre ka burime të kufizuara financiare dhe njerëzore, ndërkohë që nuk shquhet as për planifikimin e qëndrueshëm të bazuar në të dhëna.

Raportet e organizatave ndërkombëtare të publikuara në muajt e fundit shpërfaqin pozitën e palakmueshme të Kosovës në këtë aspekt. “Raporti i Grupit të Bankës Botërore mbi klimën dhe zhvillimin për Kosovën i publikuar rishtazi ka bërë të ditur se investimi në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe tranzicioni i ekonomisë nga burimet fosile tek ato të ripërtërishme do ta ndihmojë Kosovën të forcojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe të mbrojë qytetarët e saj nga rreziqet natyrore. Raporti ka konstatuar se Kosova duhet të investojë rreth 2.8 miliardë dollarë amerikanë gjatë dekadës së ardhshme për të mbrojtur banorët dhe pronat nga pasojat gjithnjë e më të rënda të ndryshimeve klimatike”, ka njoftuar “EC Ma Ndryshe”. Më tutje thuhet se, duke zbatuar iniciativën për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sipas raportit, Kosova mund ta përmirësojë zhvillimin e kapitalit njerëzor, ta ndihmojë fuqinë punëtore të fitojë aftësi të reja dhe t'i zgjerojë mundësitë për tregti. “Investimi në përshtatje do të sjellë edhe përfitime të tjera ekonomike, përfshirë sektorë kyç si bujqësia, apo sektorët e hekurudhës dhe mbetjeve, ku identifikohen



përfitime për mjedisin dhe shëndetin publik”, thuhet në njoftimin e “EC Ma Ndryshe”. Raporti nënvizon se përshtatimi i tranzicionit energjetik për të arritur emetime neto zero në të gjithë ekonominë e Kosovës deri në vitin 2050 është i mundur, por do të kërkojë transformim rrënjësor dhe veprime vendimtare në nivel kombëtar dhe rajonal. “Për shembull, termocentralet me djegie të linjtit do të duhet të dalin gradualisht jashtë përdorimit dhe të dekomisionohen plotësisht deri në vitin 2045, duke u zëvendësuar me zgjerim të theksuar të kapaciteteve të

erës dhe diellit, të mbështetura nga teknologji për depozitimin e energjisë dhe lidhje të forta rajonale. Sektori privat, sipas Bankës Botërore, do të luajë rol kritik në shtytjen e këtij transformimi duke investuar në energji të ripërtërishme, duke zhvilluar teknologji novatore dhe duke ndërtuar partneritete për të krijuar një të ardhme energjetike më të qëndrueshme”, thuhet në njoftimin e “EC Ma Ndryshe”. Para këtij publikimi raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i publikuar në vitin 2024, pat konstatuar se sa iu përket ndryshimeve klimatike, Kosova ka bërë disa përpapime

duke miratuar Ligjin për Ndryshimet Klimatike. “Megjithatë, një objektivi për neutralitetin klimatik deri në vitin 2050 mungon, dhe miratimi dhe zbatimi i legjislacionit janë ende në pritje. Miratimi i strategjive për dekarbonizim dhe adaptim është gjithashtu në pritje. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) duhet të miratohet sa më parë. Kuadri legjislativ për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin e emetimeve të gazrave serrë duhet të zhvillohet dhe të zbatohet, si dhe një mekanizëm për çmimin e karbonit për t'u përafruar me sistemin e

tregtimit të emetimeve të BE-së. Paralelisht, Kosova duhet të zbatojë masa për adaptimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike”, thuhet në raport, ku, po ashtu, kërkohet përfundimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse, përfshirë inspektimet.

Në raport me konventat ndërkombëtare, institucionet e Kosovës kanë marrë përsipër angazhime në baza vullnetare lidhur me këtë fushë, sikurse edhe zotimin për ta harmonizuar legjislacionin për energjinë dhe klimën me ato të BE-së. Madje pozicioni zyrtar i institucioneve të Kosovës është se po bëhen përpapime të rëndësishme pavarësisht prej përjashtimit të saj nga grantet shumëpalëshe të financimit për klimën. Në të njëjtën kohë pranohet se ky rrugëtim ka një kosto dhe se mbështetja ndërkombëtare është thelbësore për ta mundësuar përballjen e këtyre sfidave drejt krijimit të një të ardhmeje më të qëndrueshme për rajonin dhe Evropën.

Për këto arsye, “EC Ma Ndryshe” rekomandon institucionet e Kosovës ta thellojnë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të mundësuar diversifikimin dhe dekarbonizimin në energji, për t'i forcuar kapacitetet financiare, njerëzore e ligjore, mbështetjen e komuniteteve të prekura, përmirësimin e infrastrukturës dhe paralajmërimin e hershëm, sikurse edhe promovimin e pjesëmarrjes publike. Angazhimet në këtë drejtim do të mundësonin që Kosova të përballet në mënyrë më të përgatitur me sfidat e ndryshimeve klimatike, si dhe ta përmirësojë qëndrueshmërinë e saj, por edhe të krijojë një të ardhme më të gjelbër për qytetarët.

Kosova mbyll dy ndërmarrje publike serbe në veri

Prishtinë, 26 dhjetor - Dy ndërmarrje publike, të cilat kanë vepruar në sistemin e Serbisë në Mitrovicën e Veriut - Drejtoria për Hapësirën Banesore dhe Biznesore dhe Drejtoria për Tokën Ndërtimore - u mbyllën më 26 dhjetor.

Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha për Radio Evropën e Lirë se autoritetet lokale kërkuar ndihmë për të "çliruar disa zyra".

Zyrat e këtyre dy ndërmarrjeve gjendeshin në një ndërtesë banesore në Mitrovicën e Veriut dhe për momentin nuk dihet në emër të kujt janë këto ambiente, ku kanë funksionuar këto ndërmarrje.

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha në "Facebook" se është mbyllur një institucion, i cili

"jashtëligjshëm ka grumbulluar pagesa nga qytetarët dhe bizneset e shumta për shfrytëzimin e objekteve që janë, kinse, nën menaxhimin e tyre".

Në postimin e tij, Sveçla e publikoi edhe një video e cila duket se shfaq një fotografi të presidentit rus Vladimir Putin, dhe emblema të shtetit serb brenda objektit. "Ky keqpërdorim i realizuar nën flamujt e emblemat e Serbisë përveçqë është mbyllur sot, do të hetohet deri në fund", tha Sveçla.

Elshani theksoi se është kontaktuar edhe prokurori i kompetent, pasi është konstatuar se në këto ambiente punojnë "struktura ilegale dhe paralele".

Ai tha se është iniciuar rast për "falsifikimin e dokumenteve" dhe se ndërtesa ku kanë qenë këto



zyra të ndërmarrjeve publike serbe do të jetë nën mbikëqyrjen e policisë derisa "rasti të zgjidhet".

Pas mbylljes së zyrave të dy ndërmarrjeve serbe, Zyra për

Kosovën në Qeverinë e Serbisë reagoi duke thënë se "po uzurpohen" institucionet e Serbisë në veri dhe se këto hapa janë "në kundërshtim me marrëveshjet". "Rreth 70

punonjës të këtyre institucioneve janë legjitimuar dhe më pas janë urdhëruar të largohen nga zyrat, pasi atyre u është thënë se nuk kanë çfarë të kërkojnë atje", tha kjo zyrrë përmes një reagimi për media. Ajo i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar në Kosovë të ndërmarrë masa të menjëhershme dhe "ta parandalojë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, nga shkaktimi i konflikteve".

Ndërkaq, Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, njoftoi se "hyrja e autoriteteve të Kosovës në ndërmarrjet serbe nuk do të vë në rrezik 70 punonjësit, dhe se ata do të vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre.

Institucionet e Kosovës që veprojnë në sistemin e Serbisë konsiderohen të paligjshme dhe për këtë arsye që në fillim të vitit ka nisur mbyllja e tyre.

Guvernatori Ismaili: Viti 2024 mbyllet me rritje ekonomike 4.3 %

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka mbajtur të enjten konferencën për medie për fundvit. Ai ka thënë se viti 2024 do të mbyllet me rritje ekonomike prej 4.3-përqindësh.

Ismaili bëri me dije se, megjithëse deri në shtator ishte regjistruar një rritje prej 4.6 %, ekonomia e Kosovës pritet të mbyllet me një rritje prej 4.3 % për këtë vit.

Në lidhje me inflacionin, ai theksoi se shkalla mesatare për këtë vit ka qenë 1.6 %, një nivel që pritet të ruhet edhe gjatë vitit 2025. Po ashtu, remitancat, që përbëjnë një



burim të rëndësishëm për ekonominë e vendit, kanë arritur në 1.1 miliard euro deri në tetor dhe pritet të përfundojnë vitin në 1.3

miliard euro. "Ekonomia pritet të mbyllet me një rritje prej 4.3 % për vitin 2024. Derisa deri në shtator është arritur një rritje prej 4.6 %.

Shkalla mesatare e inflacionit në Kosovë arriti 1.7 % në nëntor, dhe pritet të jetë që inflacioni të mbyllet në 1.6 %, siç pritet të jetë edhe në vitin 2025. Remitancat kanë arritur në 1.1 miliard euro deri në tetor, dhe ne presim që të mbyllën në 1.3 miliard euro. Ky ishte viti i parë me liberalizimin e vizave, prandaj e kemi pritur një ngjarje të tillë", ka thënë ai, duke shtuar se një tjetër zhvillim i rëndësishëm është edhe rritja e investimeve të huaja direkte, të cilat kanë arritur në 657 milionë euro.

Ky trend pozitiv, sipas pritshmërive të BQK-së, do të vazhdojë edhe gjatë viteve 2025 dhe 2026. "Investimet e

huaja direkte kanë arritur në 657 milionë euro, që tregon një rritje, dhe ne presim që kjo rritje të vazhdojë edhe në vitet 2025-2026. Eksporti i shërbimeve vazhdon me një trend pozitiv", është shprehur guvernatori Ismaili.

Ndërkohë asetet e sektorit financiar, pa përfshirë BQK-në, kanë arritur në 12.2 miliardë euro, ndërsa totali, duke përfshirë BQK-në, është 14.2 miliardë euro. "Asetet e sektorit financiar kanë arritur në 12.2 miliardë euro pa përfshirë BQK-në, ndërsa 14.2 miliardë euro duke përfshirë BQK-në", ka bërë me dije guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili.

150 % rritje në kujdesin shëndetësor dhe psikologjik për Policinë e Kosovës

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Rreth 150 % më shumë pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë përfshirë në shërbimet shëndetësore gjatë këtij viti. Në total janë kryer 3 078 kontrolle sistematike për policët në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës si dhe 2 148 kontrolle psikologjike për rekrutët e rinj. Këto të dhëna u publikuan në konferencën e përbashkët për medie nga Policia e Kosovës dhe ShSKUK-ja ku janë paraqitur të arriturat e "Marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të PK-së dhe ShSKUK-së për

Shërbime Mjekësore dhe Psikologjike të Personelit Policor dhe Rekrutëve".

Drejtori i QKUK-së, Osman Hajdari, ka veçuar arritjet e marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike për personelin policor dhe rekrutët. Ai njoftoi për rritjen prej 150-përqindësh të pjesëmarrësve policorë në shërbimin shëndetësor. Pavarësisht prej angazhimit si menaxhment, falënderoj secilin pjesëtar për shërbimet që kanë bërë. Me të gjitha që kemi



bashkëpunim, të jenë në gatishmëri për të ofruar këto shërbime edhe në vitet vijuese", ka thënë Hajdari. Drejtorja e Shërbimeve Shëndetësore në Policinë e Kosovës, Lindita Kajtazi, theksoi rëndësinë e ofrimit të

shërbimeve mjekësore për personelin e Policisë së Kosovës, veçanërisht në ruajtjen e mirëqenies shëndetësore. "Ofrimi i shërbimeve mjekësore ka ndikuar në ruajtjen e mirëqenies shëndetësore të të

gjithë pjesëtarëve, zyrtarëve të Policisë së Kosovës, ka rëndësi shumë të madhe për mirëqenien e të gjithë të punësuarve të Policisë së Kosovës. Përveç kontrollimit mjekësor sistematik, kemi arritur t'i realizojmë kontrollimet mjekësore psikologjike për të gjithë aplikantët që kanë konkurruar në Policinë e Kosovës. Janë kryer edhe ekzaminime të zyrtarëve dhe ato kanë ndikuar të bëjmë një identifikim të hershëm të sëmundjeve. E gjithë kjo është arritur falë përkushtimit të përbashkët me një punë të madhe profesionale duke respektuar kodin e etikës", ka theksuar Kajtazi.

Pagesa e rrymës në veri, nën 20 %

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Disa e kursejnë, disa e paguajnë, por shumica e qytetarëve në veri të Kosovës thonë se ende nuk janë krijuar kushtet për ta paguar energjinë elektrike.

Sava nga Mitrovica e Veriut thotë për "Radion Evropa e Lirë" se "nuk e kam ndër mend ta bëj një gjë të tillë" pasi, siç thotë ai, nuk janë zëvendësuar matësit e energjisë elektrike në ndërtesën ku jeton. "Nuk kam një pasqyrë të saktë se sa energji elektrike kam konsumuar. Nuk u besoj atyre, janë të vjetër dhe duhet t'i zëvendësojnë, pastaj do të filloj të paguaj", thotë ai.

Të njëjtin qëndrim ka edhe Mirko nga komuna e Leposaviqit. Ai konsideron se faturat nuk janë reale për shkak të mosvendosjes së njehsorëve. "Nuk duhet paguar derisa 'Elektrosever' t'i zëvendësojë matësit, që gjithçka të nivelizohet dhe të vendoset që bilanci të jetë zero. Askush nuk u shmanget pagesave, por kjo çështje duhet të rregullohet", thotë Mirko.

Viti 2024 është i pari kur qytetarët e katër komunave me shumicë serbe kanë filluar të pranojnë fatura për energjinë e konsumuar. Megjithatë, niveli i

pagesës mbetet i ulët.

Sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji të Kosovës (ZRRE), nga totali prej 12 milionë eurosh për energjinë elektrike të harxhuar nga shkurti deri në nëntor të vitit 2024, qytetarët e komunave Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut dhe Zvečan kanë paguar mbi 2 milionë euro. ZRRE-ja, gjithashtu, njoftoi se sivjet është shënuar ulje prej 33 % në konsumimin e energjisë krahasuar me vitin e kaluar.

Një nga konsumatorët, Violeta nga Mitrovica e Veriut, thotë se ka filluar ta kursejë energjinë për shkak të detyrimit për pagesë. "Nga ora 10 e mbrëmjes deri në 6 të mëngjesit është tarifa e lirë, dhe unë i kushtoj shumë vëmendje kësaj", thotë ajo.

Si erdhi deri te fillimi i pagesës së energjisë elektrike në veri?

Qytetarët e veriut të Kosovës nuk kishin paguar për energjinë elektrike që nga viti 1999. Për shumë vjet borxhi i tyre është mbuluar nga qytetarët e pjesëve të tjera të Kosovës dhe më vonë nga KOSTT-i (Operatori i

Sistemit, Transmisionit dhe Tregut) dhe grante të Qeverisë së Kosovës.

Në vitin 2023 KOSTT-i u lirua nga detyrimi për të mbuluar këto humbje, falë një vendimi të ZRRE-së. Vendimi erdhi pasi kompania serbe "Elektrosever"-i mori përsipër furnizimin dhe faturimin e konsumatorëve në veri, sipas një marrëveshjeje të arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

"Elektrosever"-i është një kompani në pronësi të Elektroprivreda Srbije (EPS), e cila është e regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës. Kompania nisi shpërndarjen e faturave në fillim të vitit 2024 dhe ka filluar vendosjen e matësve të mençur, proces që ende nuk ka përfunduar.

Nga Kompania Kosovare për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS) dhe "Elektrosever"-i nuk janë përgjigjur se sa njehsorë janë vendosur deri më tash.

Por, ZRRE-ja tha se në veri ka rreth 24 mijë konsumatorë, nga të cilët 600 ende nuk kanë matës elektrikë.

Ish-ministri i Energjisë, Ethem Çeku, e konsideron pagesën prej mbi 2 milionë eurosh si shumë të ulët krahasuar me

konsumin. "Energjia është një mall që është plasuar në treg, është parim evropian, botëror dhe çfarëdo qoftë, malli në treg duhet të paguhet. Le të eliminohen rastet sociale, familjet me kushte të vështira ekonomike, por mospagesa nga familjet dhe bizneset që përdorin energjinë është e papranueshme dhe diskriminuese ndaj konsumatorëve tjerë që paguajnë", thotë Çeku për "Radion Evropa e Lirë".

Çeku thotë se ZRRE-ja duhet të kërkojë nga kompania "Elektrosever" që të gjejë forma për të rritur nivelin e pagesave në atë pjesë.

Formë tjetër ai përmend edhe trysinë përmes faktorit ndërkombëtar. "Duhet të ndërmarrin veprime konkrete, përndryshe malli që nuk paguhet mos të dërgohet. Ne e dimë që shumë çështje në Kosovë po ndërliken me politikën dhe kjo nuk duhet të ndërliket. Kjo është çështje e pastër ekonomike dhe financiare. Kjo duhet të trajtohet njëjtë si te konsumatorët në komunat tjera. Nëse nuk paguan faturat, ndërpritet energjia", thekson ai.

Konsumatorët në pjesë të tjera të Kosovës, që pranojnë faturat energjisë së shpenzuar nga Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), duhet të paguajnë deri 15 ditë nga data e pranimit të faturës. Çdo vonesë pas asaj date konsumatori mund të jetë subjekt i shkyçjes nga rrjeti elektrik. Kurse për rikyçje në rrjet konsumatorët duhet të paguajnë edhe kosto shtesë prej 17.70 eurosh.

ZRRE-ja dhe "Elektrosever"-i nuk kanë komentuar për masat që do të ndërmerren ndaj konsumatorëve që refuzojnë të paguajnë. Ndërkohë, qytetarët e veriut kanë marrë paralajmërime për shkyçje, por nuk është konfirmuar nëse janë realizuar shkyçjet.

Ndërkohë, në jug të Ibrit janë bërë thirrje të vazhdueshme për kursimin e energjisë për shkak të temperaturave të ulëta dhe kërkesës së lartë për energji. KEDS dhe KESCO kanë raportuar se kërkesa për energji elektrike ka arritur në nivele historike. Kosova aktualisht prodhon energji elektrike, por gjithashtu importon për të përmbushur kërkesat në rritje.



Murati: Për herë të parë në historinë e vendit të hyrat buxhetore kanë tejkaluar shifrën 3 miliardë euro

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se për herë të parë në historinë e vendit të hyrat buxhetore kanë tejkaluar shifrën 3 miliardë euro.

"Për herë të parë në historinë e vendit të hyrat buxhetore kanë


tejkalar shifrën 3 miliardë euro, duke arritur realizim 100% të planifikimit vjetor, ende pa përfunduar viti", ka shkruar Murati në "Facebook". Ai ka thënë se ky buxhet ka mundësuar pagesën e mbi 840 milionë eurove për paga në

sektorin publik, rreth 450 milionë euro mallra e shërbime siç janë barnat esenciale apo furnizimet për mbrojtje e siguri, rreth 1.1 miliard për pensione dhe shtesa për fëmijë e subvencione në bujqësi. "Më e

rëndësishmja, për herë të parë në historinë e vendit investimet kapitale kanë tejkaluar vlerën mbi 600 milionë euro - shifra e saktë dihet tek pasi të jenë paguar të gjitha faturat që janë pranuar sivjet", ka shkruar Murati.



SKENARËT: Nëse do të ndodhte një stuhi diellore



Imagjinoni sikur energjia elektrike të ndërpritej papritur dhe të mos kthehej për orë, ditë apo javë të tëra. Vështirësitë fillestare, si mungesa e televizorit apo frigoriferit, do të shndërroheshin shpejt në një katastrofë globale: spitalet paralizohen, Interneti nuk funksionon, Gps-të janë të padobishëm, trenat dhe avionët ndalojnë së lëvizuri. Ndërkohë, në qiell do të shfaqeshin aurora spektakolare, por çmimi do të ishte i lartë. Ky skenar nuk është fantashkencë, por një mundësi reale në rast të një stuhie diellore ekstreme.

Ngjarja e Carrington-it

Për të kuptuar këtë fenomen, duhet të kthehemi pas në kohë. Dielli ynë, megjithëse duket i qëndrueshëm, është vendi i aktiviteteve të dhunshme që shpesh nuk i vërejmë. Në shtator 1859 ndodhi një ngjarje e tillë, e

njohur si Ngjarja e Carrington-it, kur një stuhi diellore e fuqishme goditi Tokën. Në atë kohë, teknologjia ishte e kufizuar tek telegrafi, dhe efektet përfshinin ndërprerje të linjave dhe shkëndija nga shtyllat e telegrafit. Ndërkohë, urora boreale u panë deri në Kubë, Hawaii dhe Xhamajka.

Fenomenet e dhunshme diellore në të kaluarën

Stuhia diellore e vitit 1859 ishte rreth 10 herë më e fuqishme se një ngjarje e ngjashme që ndodhi në maj 2024. Në shekullin e 20-të dhe të 21-të ka pasur raste të tjera të fuqishme, si stuhia geomagnetike e marsit 1989, që shkaktoi një ndërprerje 10-orëshe të energjisë elektrike në Quebec dhe problemet e sistemit elektrik në SHBA. Një tjetër stuhi, në maj 1921, shkaktoi zjarre dhe dëme në linjat telegrafike.

Studimet mbi izotopet radioaktive në shtresat e akullit tregojnë se në 1,000 vitet e fundit ka pasur stuhi edhe më të forta se ajo e Carrington-it. Megjithatë, këto fenomene janë të paparashikueshme dhe mund të ndodhin në çdo moment.

Skenari i "stuhisë perfekte"

Një stuhi ekstreme fillon me shfaqjen e njollave të mëdha në sipërfaqen e Diellit, të cilat çlirojnë energji magnetike dhe përfundimisht plazma të nxehura. Kur ky material arrin Tokën, ai ndërvepron me fushën magnetike të planetit, duke shkaktuar stuhi geomagnetike.

Efektet përfshijnë:

Dëmtim të satelitëve: Rrezatimi i lartë energjik ngroh dhe zgjeron atmosferën, duke shkaktuar më shumë fërkim mbi satelitët.

Probleme për astronautët dhe avionët: Rrezatimi paraqet rrezik për ata që ndodhen në orbitë ose në udhëtime mbi polet. Prishje të rrjeteve elektrike: Rrymat induktive të gjeneruara nga stuhitë geomagnetike mund të dëmtojnë transformatorët dhe linjat elektrike.

Pasojat e një ndërprerjeje globale të energjisë



Nëse një stuhi e tillë ndodh sot, efektet do të ishin katastrofike. Transformatorët e dëmtuar nuk mund të zëvendësohen shpejt, pasi prodhimi i tyre kërkon muaj të tërë. Pa energji elektrike, ndalen jo vetëm pajisjet shtëpiake, por edhe transaksionet bankare, sistemet telefonike dhe transporti publik. Supermarketet boshatisen shpejt dhe mungesa e ujit të pijshëm bëhet një problem i madh.

A jemi të përgatitur?

Për momentin, burimet për monitorimin e "moti hapësinor" janë të kufizuara. Satelitët aktualë si Soho dhe Solar Dynamics Observatory janë të vjetër dhe nuk mund të japin të dhëna në kohë reale. Misioni Vigil i ESA-s, planifikuar për vitin 2031, mund të përmirësojë situatën, por aktualisht parashikimet janë të kufizuara në një sistem të quajtur "nowcasting"—thjesht vëzhgimi i çfarë po ndodh në moment.

Si të kufizojmë dëmet?

Strategjitë për të përballuar këto fenomene përfshijnë monitorimin e vazhdueshëm dhe ndarjen e rrjetit elektrik në segmente për të parandaluar përhapjen e dëmeve. Megjithatë, ndërgjegjësimi dhe përgatitja për një skenar të tillë mbeten të ulëta në shumicën e vendeve. / [bota.al](#)



Antonio Ileski, përforcimi i parë i FC Ferizaj

FERIZAJ, 26 DHJETOR - Klubi i Ferizajt ka paraqitur futbollistin më të ri, Antonio Ileski. 28-vjeçari është lojtari i parë që e përforcon skuadrën që bën gara në Superligë, kurse aktivizohet në pozitën e qendërmbrojtësit. "FC Ferizaj

ka kënaqësinë të njoftojë arritjen e marrëveshjes me mbrojtësin e qendrës, Antonio Ileski. Futbollisti 28-vjeçar është një përforcim i rëndësishëm për skuadrën, duke sjellë lartësi e eksperiencë në vijën e mbrojtjes. Antonio

Ileski, që së fundmi ka qenë pjesë e klubit Voska Sport në Maqedoninë e Veriut, më parë ka luajtur për klube të njohura si Renova, Flamurtari i Vlorës, Kukësi. FC Ferizaj është i sigurt që me ardhjen e Ileskit, skuadra do të përforcohet në

mbrojtje dhe do të rrisë mundësitë për të pasur një sezon të suksesshëm", thuhet në njoftimin e Ferizajt. Ferizaj synon mbijetesën në elitën e futbollit të Kosovës. Stinorin vjeshtor e mbylli në vendin e tetë me 20 pikë.



Khaka në formacionin e vitit në Bundesliga

LEVERKUSEN, 26 DHJETOR - Ylli shqiptar i Bayer Leverkusenit, Granit Xhaka, ka përfunduar si pjesë e formacionit më të mirë të vitit 2024 në kampionatin gjerman Bundesliga. Viti 2024 ka qenë vit interesant në Gjermani, pasi Bayer Leverkuseni ka thyer hegjemoninë e Bayern Munichut, duke rrëmbyer titullin kampion. "Aspirinat" ishin skuadra më e mirë e edicionit 2023/24 dhe kjo erdhi falë disa prej yjeve më të mëdhenj dhe trajnerit Xabi Alonso. Pas përfundimit të këtij gjysmë-sezoni, faqja e specializuar e statistikave "SofaScore" ka publikuar formacionin më të mirë të

vitit 2024 në Bundesliga. Pjesë e këtij formacioni është edhe mesfushori shqiptar Granit Xhaka, i cili pati një vit brilant me Leverkusenin, duke qenë një nga liderët e ekipit. Përveç Xhakës, pjesë e formacionit nga Leverkuseni janë edhe Florian Wirtz dhe Alejandro Grimaldo, ndërsa nga Bayerni janë Joshua Kimmish, Jamal Musiala dhe Harry Kane. Në formacion kanë zënë vend edhe Willi Orban, Nico Schlotterbeck, Nadiem Amiri dhe Omar Marmoush. Viti 2024 mund të vlerësohet lirisht si viti i futbollit Granit Xhaka, i cili me Leverkusenin arriti të bëjë histori. Xhaka me Leverkusenin e fitoi

Bundesligën dhe Kupën e Gjermanisë, derisa arriti edhe në finale të Ligës së Evropës ku është mposhtur nga Atalanta. Granit Xhaka është i nominuar për "Sportistin e Vitit" në Zvicër si i vetmi futbollist, pasi në listë vijnë nga sportet e tjera. Xhaka ka fituar tri herë çmimin futbollist më i mirë në Zvicër: 2017, 2022 dhe 2023. Ai ishte i 16-ti në renditjen e "Topit të Artë".

FORMACIONI I VITIT 2024 NË BUNDESLIGA:
Ronnnow; Kimmich, Orban, Schlotterbeck, Grimaldo; Amiri, Xhaka, Wirtz, Musiala; Marmoush, Kane.



Bora befason Prishtinën



PRISHTINË, 26 DHJETOR - Bora ka fituar derbin prishtinas ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 81:76 (20:19, 17:21, 24:17, 20:19), në ndeshjen e mbetur të xhiros së nëntë të ProCredit Superligës. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, me epërsi prej tetë pikësh, 11:3, por mysafirët u rikthyen shpejt, duke barazuar shifrat në 12:12,

ndërsa çereku i parë përfundoi 20:19. Bardhekaltrit në periudhën e dytë kishin epërsi konstante prej pesë pikësh, kurse pjesa e parë përfundoi 37:40. Në periodën e tretë bardhekaltrit u shkëputën deri në tetë pikë epërsi 46:54, por Bora me një seri prej 11:0 përmbysi shifrat në 57:54, derisa rezultati pas 30

minutash ishte 61:57. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua përballje interesante, ku Bora ngriti epërsinë në 77:67, por bardhekaltrit afruan shifrat në 77:74, por nuk arritën të bëjnë më shumë dhe Bora triumfoi 81:76. Njëkohësisht kjo ishte fitorja e parë për Borën ndaj Sigal Prishtinës. Për Borën ky është edicioni i parë në elitë.

Më të mirët te Bora ishin Rrezart Memedi me 24 pikë e shtatë kërcime dhe Adem Mekiq me 20 pikë, katër kërcime e nëntë asistime, ndërsa te Sigal Prishtina më i dalluari ishte Henrik Sirko me 20 pikë e shtatë kërcime. Bora ka katër fitore e nëntë humbje, ndërsa Sigal Prishtina gjashtë fitore e shtatë humbje.

Arbër Shala largohet nga Dukagjini

KLINË, 26 DHJETOR - Futbollisti Arbër Shala edhe zyrtarisht është larguar nga Dukagjini i Klinës. Shala ishte pjesë e skuadrës elitare që katër vjet e gjysmë dhe kontributi për ngjyrat e Dukagjinit ishte i

madh. Klubi në fjalë e ka falënderuar futbollistin Shala për kontributin dhe i ka uruar suksese në të ardhmen. "Ju njoftojmë se, me marrëveshje të dyanshme, kemi ndërprerë bashkëpunimin me Arbër

Shalën. Klubi ynë shpreh mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm të Shalës gjatë 4 viteve e gjysmë si pjesë e ekipit tonë. Përkushtimi, pasioni dhe profesionalizmi i tij kanë lënë gjurmë të

pashlyeshme. Arbërit i urojmë suksese të mëdha në karrierën e tij të mëtejshme, duke e siguruar se dyert e klubit tonë do të jenë gjithmonë të hapura për të. Faleminderit që ishe pjesë e familjes sonë,



Arbër!", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

LeBroni fiton duelin me Curryn, Philadelphia mposht kampionët e Bostonit

BOSTON, 26 DHJETOR - Kampionët e Bostonit u mundën me rezultat 118-114 në fushën e tyre nga Philadelphia, ndeshje me rivalitet dhe shumë emocione. Maxey me 33 pikë e Embiid me 27 pikë ishin më të mirët për Philadelphia, duke i bërë të

pavlefshme 32 pikët e Tatumit për Celticsin. Fitore në sekondat e fundit për lakersat, që mundën me rezultat 115-113 Golden Staten jashtë fushës. LeBron Jamesi me 31 pikë e 10 asistime ishte lider për lakersat, mbështetur nga Reaves me 26

pikë. Curry realizoi 38 pikë për Warriorsin, por që mbetën për statistikë. Skuadra e Phoenixit mundi me shifrat 110-100 Denverin, sfidë ku diferencën në fushë e bëri dyshja Durant - Beal, që realizuan nga 27 pikë secili. Minnesota, falë 26 pikëve



REZULTATET

New York - San Antonio	117-114
Dallas - Minnesota	99-105
Boston - Philadelphia	114-118
Golden State - Lakers	113-115
Phoenix - Denver	110-100

të Edwardsit, mundi me rezultat 105-99 Dallasin, ndërsa New York triumfoi me rezultat 117-114 ndaj San Antonios (Bridges 41 pikë).

Usyk: Fury është kundërshtari më i fortë, por unë fitova

LONDËR, 26 DHJETOR - Pasi mbrojti titujt kampionë bote në peshën e rëndë, duke fituar revanshin me Tyson Fury, boksieri ukrainas Oleksandr Usyk nuk e ka vendosur ende se kur do të rikthehet në ring. I

pamposhtur në karrierën e tij, Usyk fillimisht iu përgjigj akuzave të Furyt se atij iu vodh fitorja. "Për mua nuk ka problem se çfarë thotë ai. Unë fitova, kaq më mjafton", ka thënë Usyk, që më pas duke qeshur shtoi: "Tysoni është

shoku im më i mirë. Unë e respektoj shumë atë djalë sepse mendoj se është kundërshtari im më i ashpër që kam pasur. Tyson Fury më bën të fortë". "Tyson Fury është një kundërshtar i madh. Ai është një njeri i mirë. Tyson


flet shumë, por gjithçka e bën vetëm për 'show'. Unë e respektoj shumë atë. Ne ndamë së bashku 24 raunde në ring dhe sfidat tona tani janë bërë histori", u shpreh



Oleksandr Usyk, i pamposhtur në karrierën e tij.

Mehmeti: Kam lindur në Angli, por gjaku im është shqiptar dhe flas shqip

TIRANË, 26 DHJETOR - Anis Mehmeti ka gjetur shtegun e tij, duke shpresuar t'i ndjekë gjurmët e shkëlqyera të yjeve të futbollit anglez si Bukajo Saka dhe Rahem Sterling. Anësori i Bristol Cityt ëndërron ta shfaqë talentin e tij në fushën e madhe të "Wembley", ndërsa Anglia nis fushatën kualifikuese për Kupën e Botës 2026 këtë mars. Me tri ndeshje për Kombëtaren shqiptare, aspiratat e Mehmetit pasqyrojnë një rrugëtim që filloi në rrugët plot zhurmë të Londrës Veriore, ku ai dalloj me aftësitë e tij në ekipet lokale dhe tani vetëm 23 vjeç, është i vendosur që të lerë gjurmë në futbollin ndërkombëtar. Ai kujton me mall kur ka mësuar lojën që në moshën trevjeçare, duke luajtur futboll çdo ditë në lagje. "Unë u rrita në një shtëpi të thjeshtë dhe gjithçka që doja të bëja ishte të luaja futboll. Këtu mësova të jem i patrembur", thotë ai fillimisht për "3pointsforawin". Udhëtimi familjar i Mehmetit në Angli filloi më shumë se 25 vjet më parë dhe trashëgimia e tij shqiptare mbetet një pjesë e rëndësishme e identitetit të tij. "Kam lindur në Angli, por gjaku im është shqiptar dhe flas shqip", shpjegoi ai. Vizitat e tij verore në Shqipëri kanë rrënjësuar një lidhje të thellë me rrënjët e tij dhe ai ëndërron të përfaqësojë Shqipërinë kundër Anglisë. Me perspektivën për t'u përballur me lojtarë të nivelit të lartë si Walker dhe Arnold, Mehmeti mbetet i patrazuar. "Unë gjithmonë bëj shaka me djemtë se, me respekt, nuk më intereson kush është para meje", ka thënë ai me besim. "Ndeshja Angli-Shqipëri, është ajo lloj sfide për të cilën ju jetoni", thotë ai. Vendosmëria e tij për të provuar veten kundër më të mirëve është e dukshme dhe ai e pret me padurim mundësinë. Pavarësisht pasionit dhe gatishmërisë, Mehmeti është përballur me sfida për të siguruar një vend në Kombëtare. "Kam luajtur tre herë për Shqipërinë, por ka pasur një periudhë ku nuk jam thirrur



gjatë vitit të kaluar. Kjo është zhgënjyese, por shpresoj se do të kem një shans për të luajtur kundër Anglisë", shprehet Mehmeti duke shpresuar që me punën e palodhur dhe më shumë gola për Bristolin gjatë kësaj kohe, do t'i bëjë sërish përshtypje Silvinhos. Që kur u bashkua me Bristolin për 1 milion paund nga Wycombe në janar 2023, Mehmeti është bërë i preferuari i tifozëve, duke shënuar gjashtë gola këtë sezon. Rrugëtimi i tij drejt futbollit profesionist nuk ka qenë i menjëhershëm. Pas një karriere me të rinjtë në Fullham, Tottenham dhe Noruiç, ai e gjeti veten pa një klub gjatë pandemisë Covid. Duke reflektuar për ato kohë sfiduese.

"Përfundova pa klub për një kohë për shkak të Covid. Kam pasur gjithmonë besim te vetja, por ka dyshime kur janë pesë muaj pa klub", tregon ai që shkoi në kategorinë e pestë angleze dhe më pas shfrytëzoi mundësinë për të shkuar në prove tek Uikombe, aty ku gjithçka përfundoi me sukses. Me synimet e tij drejt lavdisë ndërkombëtare dhe dëshirës për të përfaqësuar Shqipërinë në skenën botërore, historia e Anis Mehmetit është një histori e vendosmërisë, pasionit dhe dashurisë së palëkundur për lojën e bukur. Rrugët e Londrës Veriore mund të kenë qenë pikënisja e tij, por "Wembley" së shpejti mund të jetë destinacioni i tij i radhës.

SHKURT

Egnatia synon transferimin e Berishës

Pas Frederic Veselit, kampionia e Shqipërisë në futboll, Egnatia, po e synon një reprezentues tjetër të Kombëtares së Shqipërisë. Sipas medimeve në Shqipëri, bëhet fjalë për portierin Etrit Berisha, i cili mund të jetë përforcimi i madh i Egnatinas në afatin kalimtar të janarit. Në fakt, Berisha është lojtar i lirë dhe ideja për t'u zhvendosur në Kategorinë Superiore deri në fund të sezonit po duket e realizueshme. Kjo do t'i jepte mundësinë Berishës të ketë minutazhë dhe të rikthehet sërish protagonist në fushën e lojës, me synim për të siguruar një transferim në Evropë për sezonin e ardhshëm. Realizimi i këtij transferi nuk do të jetë aspak i lehtë për shkak të kërkesave të larta financiare të Berishës, por tek Egnatia nuk po heqin dorë nga kjo ide. Berisha 35-vjeçar prej korrikut të këtij viti është pa klub pasi i skadoi kontrata me Empolin, ndërsa në Itali ka bërë karrierë edhe te Torino, SPAL-i, Atalanta e Lazio. Ai, gjithashtu, ka edhe 80 paraqitje me fanellën e Kombëtares së Shqipërisë.

Interi refuzoi ofertë të majme për Asllanin

Gazetari i njohur italian Nicolo Schira ka zbuluar një prapaskenë interesante për sa i përket Kristjan Asllanit. Ai bën me dije se klubi i Interit ka refuzuar një ofertë të majme për mesfushorin shqiptar. Sipas gazetarit italian, oferta e mbërritur në adresën e zikaltërve ka ardhur nga një ekip i Premierë Ligës. Interi duket të jetë i kënaqur me performancën e Asllanit ditët e fundit pavarësisht prej minutave të paktë që po merr. Në ndeshjen e parafundit që zhvilloi Interi ndaj Udineses, Asllani shënoi supergol nga goditja këndore.

Hamiltoni: Do të jetë një dimër i vështirë, kam pak kohë për të mësuar gjithçka nga e para

Pas disa ditësh, nga 1 janari, Lewis Hamiltoni do të jetë zyrtarisht një pilot i Ferrarit. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 do ta lërë Mercedesin për të nisur një aventurë të re me "kokëkuqen". Hamiltoni pranon se këto muaj do të "fluturojnë" për të, teksa i duhet të përshtatet me një realitet të ri: "Ky do të jetë pushimi më i shkurtër dimëror që kam pasur ndonjëherë në shumë vite". "Do të më duhet të përballem me një kurbë mësimi mjaft të pjerrët, ndërsa ndërroj ekipin dhe do të më duhet t'i asimiloj procedurat që janë të reja për mua. Unë dua të jap gjithçka, absolutisht gjithçka", u shpreh Hamiltoni. Më tej, britaniku shtoi: "Jam jashtëzakonisht i emocionuar për këtë aventurë të re dhe mezi pres të takoj të gjithë ekipin. Do t'i përkushtohem me gjithçka kësaj aventure të re me Ferrarin, për t'i arritur objektivat tona".

Barça, gati ta rinovojë kontratën me Lewandowskin

Barcelona po mendon ta rinovojë kontratën me sulmuesin Robert Lewandowski. Trajneri Hansi Flick është i kënaqur me paraqitjet e sulmuesit polak. Me 23 gola në 24 paraqitje, Lewandowski i ka bindur drejtuesit, të cilët po përgatisin shpërblimin për të. 36-vjeçari ka kontratë deri në verën e vitin 2026, ndërsa pritet ta zgjasë bashkëpunimin deri në vitin 2027. Ish-sulmuesi i Bayernit është një nga pikat kyçe ku mund të mbështetet për fitimin e trofeve në të ardhmen.

Titulli 2025 në Formula 1, Norrisi është favorit sipas basteve

Edhe pse duhen gati tre muaj deri në fillimin e kampionatit botëror të Formulës 1 për vitin 2025, që tani janë projektuar kandidatët për triumfin final. Favoriti kryesor për t'u shpallur kampion sipas kompanive të

basteve është Lando Norris. Piloti i Mek Larenit, i cili e mbylli Botërorin 2024 në vend të dytë, ka koeficientin më të ulët për fitimin e titullit, 2.87. Pas tij, me diferencë jo të madhe vjen kampioni i katër

sezoneve të fundit, Maks Verstapen, teksa titulli i pestë për pilotin e Red Bullit jepet me koeficientin 3.25. Podiumin e favoritëve e plotëson Charl Lëklerk i Ferrarit, me koeficientin 5. Me shumë

interesim po pritet debutimi i Luis Hamiltonit me Ferrarin, teksa britaniku pritet të zbrisë në pistën e Fioranos në teste mes datave 20-21 janar. Por shtatë herë kampioni i botës në F1 është i katërti në renditjen e

pretendentëve sipas kompanive të basteve, teksa triumfi i tij kuotohet me koeficientin 8.5. Kampionati botëror i Formulës 1 do të fillojë më 16 mars 2025 në Australi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 2035/1
Dt: 26.12.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren	Prizren	Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	Vend i lirë	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetim)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përfundimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2021, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar nga të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në webfaqe.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 27.12.2024 deri me 25.01.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Labinot Haziri nga Prishtina shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Ardian Bozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Ardian Pozhegu" B.I. Me nrb: 810244012. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Blenda Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi". - Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 2260129 të datës 24.12.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 24.12.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo filllore
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik
Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacioni i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

> Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njëerën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

> Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

> Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 26.12.2024 deri me datë 09.01.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 16.01.2025.

- Afati për ankesë nga data 17.01.2025 deri me datë 21.01.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 24.01.2025.
- Afati për ankesë nga data 27.01.2025 deri me datë 29.01.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 06.02.2025 deri me datë 10.02.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 14.02.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

> Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.


Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

> Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



2260/24
24.12.24

U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A. u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Perparimi“ Sh. A“ Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 0258/24 od 24.12.2024, godine od Izvršnog direktora, N.P.L. „Perparimi“ Sh. A. 24.12.2024 objavljuje:

„JAVNI KONKURS

- I. Naziv:** Fizičko osiguranje – čuvar °
Broj izvršitelja: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje imenovanja: Određeni period od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) mjeseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna sprema: Srednja škola ili osnovna škola
Radno iskustvo: Poželjno šest (6) mjeseci
Izveštava: Rukovodilac Odsjeka za fizičko osiguranje
Visina mjesečne bruto plate: 390.00€ bruto.

Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograničenja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slučaju opasnosti odmah obavještava nadležne osobe;
- Po potrebi može biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizičkog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predviđene zaštitne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti, protivpožarnu opremu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizičko osiguranje za obavljene posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Fizička sposobnost, poželjno je da ima završene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Poželjno je da ima licencu iz oblasti fizičkog osiguranja;

Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu N.P.L. „Perparimi“ Sh. A - Vučitrn;
- Dokaz o stručnoj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti)
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Stručnog vijeća Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnom krivičnom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju lične karte (skenirano);

Dokumenti koji su potrebni pre uspostavljanja radnog odnosa:

- Potvrda o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Zdravstveni sertifikat.

➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 26.12.2024 do datuma 09.01.2025 u 16:00 sati.

Približni kalendar postupka regrutacije:

- Verifikacija uspjeha aplikacija kandidata najkasnije do 16.01.2025.
- Rok za prigovor od 17.01.2025 do 21.01.2025.
- Period kandidata kada će biti podvrgnuti pisanom testu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do 24.01.2025.
- Rok za prigovor od 27.01.2025 do 29.01.2025.
- Period kandidata kada će biti podvrgnuti usmenom intervjuu, i kada će se vršiti njihova evaluacija, biće najkasnije do 05.02.2025.
- Rok za prigovor od 06.02.2025 do 10.02.2025.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom biće najkasnije 14.02.2025

Narativni kalendar postupka regrutacije može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, i u zavisnosti od rada ocenjivačke komisije i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnese žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok se ista ne razmotri od strane Komisije za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavi formular u Arhivu NPL "Perparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Glenij Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebnog pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svojom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ ZAKLJUČAK

N.P.L. "Perparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a srpske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pa se podstiču da se prijave.

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Në bazë të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 13 të ligjit nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe ligjit nr. 06/L-021 neni 22 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë me datë 26.12.2024, mori vendim që të rishpallë, konkursin me afat prej 30 ditë për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm:

KONKURS

Pozita e punës: Zyrtar/e i Auditimit të Brendshëm - 1 (një) pozitë

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë,

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm / Nën mbikëqyrje të Komisionit të Auditimit

Niveli i pagës: Niveli II

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës së punës tri (3) vjeçare

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- I raporton komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për politikën, programet dhe aktivitetet e zyrës.
- Të planifikojë, organizoj dhe mbikëqyrë punën e zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditimit, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
- Përgatitja e planit të punës, zbatimi dhe monitorimi.
- Të monitorojë zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregull të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni i Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregull të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga KRM "Pastrimi" Sh.A të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
- Të propozoj masa që duhet të ndërmerren nga kompania për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë.
- Në bazë të planit të auditimit, përgatitë raportet e auditimit për shqyrtim nga Komisioni i Auditimit.
- Bashkëpunon me zyrtarët e ndërmarrjes në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera te cilat i caktohen nga komisioni i auditimit.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet.
- master në drejtimit ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditim do te jetë përparësi
- Së paku 5 vite përvojë pune menaxhuese në auditim të brendshëm, 5 vite përvojë menaxhuese në auditim të brendshëm konsiderohet përparësi;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve të dëshmohet me kontrata, vendime;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe i ligjeve qe kane te bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve (word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik leshuar nga MEF ose nga ndonje institucion relevant vendor ose ndërkombëtar si: përparësi është SKAK, etj.

Paraqitja e kërkesave

- Kërkesat merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. Tahir Zajmi" nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV, Përvoja e punës e dëshmuar me dokumente veçmas dëshmi për përvojën menaxhuese në auditim (dokumente origjinale ose te noterizuara), Vërtetim nga trusti pensional, Diplomat e shkollimit fakultetit (e noterizuar), Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (dëshmi e noterizuar), Çertifikata e Auditimit (e noterizuar), Çertifikata e lindjes jo me e vjetër se gjashtë muaj, Kopja e letërnjoftimit, dëshminë se nuk jeni nën hetime jo me e vjetër se gjashtë muaj (origjinali).
- Deklarata nën betim.
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
- Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tre (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen, do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

Afati për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit të Konkursit Publik në mjete të informimit duke filluar nga data: 27.12.2024 deri me datën 27.01.2025 ora 08:00-16:00.



Prema članu 21, član 25 Zakona br. 03/L- 087 o javnim preduzećima, član 13 Zakona br. 04/L-111 o izmjeni i dopuni zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, kao i Zakon br. 107. 06/L-021 član 22 o internoj reviziji javnih finansija, Odbor za reviziju javnog preduzeća KRM "Pastrimi" Sh.A. Dana 26.12.2024. godine u Prištini donesena je odluka da se konkurs ponovo zapečati rokom od 30 dana za radno mesto službenika interne revizije:

TAKMIČENJE

Radno mesto: Službenik interne revizije - 1 (jedna) pozicija

Lokacija i lokacija: lokacija

Službenik za internu reviziju / Pod nadzorom Odbora za reviziju

Niveli i pagës: Niveli II

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje ugovora od tri (3) godine

Dužnosti i odgovornosti:

- Izveštaj Odboru za reviziju i Upravnom odboru o politikama, programima i aktivnostima Kancelarije.
- Planiranje, organizovanje i nadzor rada Kancelarije za internu reviziju, uključujući planiranje, osmišljavanje i upravljanje programom revizije, organizovanje i
- Delegiranje radova i obračun potrebnih resursa.
- Priprema plana rada, implementacija i monitoring.
- Prati sprovođenje svih preporuka Odbora za reviziju.
- Proveri adekvatnost i redovno funkcionisanje internih kontrola (uključujući i finansijske) i izveštava Odbor za reviziju.
- Da proveri prikladnost i redovno funkcionisanje sistema i procedura kojima se garantuje sprovođenje svih važećih zakona na Kosovu od strane RM "Pastrimi".
- Predložiti mere koje će kompanija preduzeti kako bi se povećala efikasnost i efektivnost aktivnosti.
- Na osnovu plana revizije, pripremiti revizorske izveštaje za razmatranje od strane Odbora za reviziju.
- Sarađuje sa zvaničnicima kompanije u koordinaciji sa izvršnim direktorom.
- On takođe obavlja druge zadatke i zadatke koje dodeljuje odbor za reviziju.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Visoka stručna sprema iz oblasti ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, računovodstva.
- Master u ekonomskim pravcima sa naglaskom na računovodstvo i reviziju će biti prednost
- Najmanje 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom, 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom smatra se prioritetom.
- Znanje i iskustvo u oblasti revizije dokazuje se ugovorima, odlukama;
- poznavanje važećih zakona i propisa u skladu sa Zakonom o UN i zakonima koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Komunikacijske veštine, planiranje rada i vođenje tima;
- Računarske veštine u softverskim aplikacijama (word, Excel, Power Point, Access);
- Biti sertifikovan u internoj reviziji u javnom sektoru, kvalifikovan od strane MEF-a ili bilo koje relevantne domaće ili međunarodne institucije kao: prioritet je SKAK, itd.

Bitka kod Kërkesave

- Zahtevi se primaju i dostavljaju u kancelariju br. 8. KRM "Pastrimi" SH. A, Tahir Zajmi" br.5, Priština i sledeća dokumenta moraju biti priloženi:
- CV, Radno iskustvo dokazano posebnim dokumentima dokaz za iskustvo upravljanja u reviziji (originalni ili overeni dokumenti), Potvrda iz penzionog fonda, Fakultet Stepen školovanja (overen), Diploma sa stranih univerziteta mora biti obaveštena od strane Ministarstva prosvete (overen dokaz), Potvrda o reviziji (overena overena), Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci, Kopija lične karte, dokaz da niste pod istragom ne stariji od šest meseci (original).
- Deklarata nën betim.
- Nekomplikovani dokumenti i oni koji stignu nakon roka za takmičenje neće biti pregledani.
- Kontaktirajte se samo kandidati koji su ušli u uži izbor.
- Dodatne informacije mogu se dobiti putem telefona 038/603-191.

Napomena: Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i razmatraće se ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i one koje nisu popunjene sa relevantnom dokumentacijom neće biti razmatrane, već će se kontaktirati samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume i uvršteni su u usku listu.

Rok za prijavljivanje je 30 dana od dana objavljivanja javnog konkursa u medijima sa početkom od: 27.12.2024. godine do 27.01.2025. godine od 08:00 do 16:00 časova.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

